

FJALA E DEPUTETES ALBANA VOKSHI

E ENJTE 17 NËNTOR 2022

Në fakt, ishte e pritshme që ju të mos e pranoni debatin, sepse do t'i mbroni deri në fund ministrat tuaj që janë bërë edhe investitorë strategjikë. Por ajo që ju po tentoni të bëni, dhe është dukshme, është se po tentoni t'i mbyllni gojën opozitës. Nuk i referohem vetëm kësaj seance, por u referohem edhe komisioneve parlamentare, ku keni hequr të drejtën e fjalës, na keni hequr të drejtën e fjalës ne, deputetëve, siç po na e hiqni edhe sot, u keni hequr të drejtën e fjalës grupeve të interesit, sepse nuk është parë ndonjëherë që të diskutohet buxheti nen për nen dhe palët e interesit të mos ftohen dhe të mos thirren.

Ju keni frikë nga fjala dhe ndaj ajo që bëni; shkelni në mënyrë të vazhdueshme Rregulloren, shkelni në mënyrë të vazhdueshme Kushtetutën, duke e kthyer këtë aulë, që duhej të ishte aula e demokracisë, ku të gjithë qytetarët të dëgjonin sesi ne mbrojmë interesat e tyre, në vendin ku po mbrohen dhe ju po i certifikoni me arrogancën e votave ministrat tuaj, që po rrëmbejnë pronat, që po kthehen edhe në investitorë strategjikë.

Ajo çka unë do të kërkoj është që të merret masë për Edi Ramën. Vajzat e mia në shtëpi janë tmerruar nga gjuha e Kryeministrit. Gjithë fëmijët, që kanë dëgjuar televizionin para një jave, janë tmerruar nga gjuha e Kryeministrit. Ky është shembulli që u japim fëmijëve tanë? Ky është shembulli që ne përcjellim te fëmijët shqiptarë? Është gjuhë e papranueshme. Kam kërkuar nga të gjitha gratë deputetë që të distancohen nga gjuha e Kryeministrit, por askush nuk ka reaguar.

Kërkoj që të merret masë, që të përjashtohet Edi Rama, siç u mor masa e padrejtë, krejt e padrejtë, për dy kolegët e Partisë Demokratike. Të mblidhet urgjentisht komisioni dhe të marrë masë për përjashtimin e Edi Ramës, për gjuhën vulgare dhe banale që ka përdorur këtu në Parlament.